



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 373/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Ferid Osmani dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën, e Suzana Novobërdaliu, përfaqësuese ligjore e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), që ka të bëjë me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009 “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në seancën e mbajtur me datë 12.12.2010 mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET Ankesa si e pabazuar e subjektit politik AKR.

ARSYETIMI

Suzana Novobërdaliu, përfaqësuese ligjore e subjektit politik AKR dega në Prishtinë, ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik AAK, e cila ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke bërë Veprime të Ndaluar aktivitetet e AAK-së kanë mbuluar posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Kosovës nga radhët e AKR-së Petrit Nimani me atë të kandidatit për deputet në Parlamentin Kosovës nga radhët e AAK-së Ardian Gjini.

Më 09 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Suzana Novobërdaliu, përfaqësuese ligjore e subjektit politik AKR dega në Prishtinë, duke pretenduar se subjekti politik AAK, ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke mbuluar posterat e AKR-së me ata të AAK-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një foto si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

Rregulla dhe Procedurat e PZAP-it neni 3.6 pika b parasheh:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

Duke e shqyrtuar ankesën e AKR-së përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave dhe të përshkrimit të hollësishëm lidhur me atë se në cilën kohë dhe vend ka ndodhur shkelja e pretenduar nga ana e AAK.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 373/2010 më datën 12.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha

